

GJ.L nr. 1309/2012

DPK/DMP

03-4406/12

02

07.12.2012

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e Sek. juridike Nexhmije Abazxhik, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Izedin Bytyqi nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 14834/2012 të dt. 18.09.2012, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 dhe konform nenit 221 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 20.11.2012, merr këtë:

## **A K T V E N D I M**

**NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 14834/2012 të dt. 18.09.2012, vetëm sa i përket gjobës së shqiptuar; ashtu që të pandehurit Izedin Bytyqi nga Prishtina, për veprën kundërvajtëse nga neni 8.1 të sanksionuar sipas neni 17 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, i shqiptohet gjoba në shumë prej 1500 (Njëmijë e pesëqind) Euro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në të kundërtën gjoba e shqiptuar do t'i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh. Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

## **A R S Y E T I M**

**Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë**, sipas aktvendimit Nr. regj. 14834/2012 të dt. 18.09.2012, të pandehurin Izedin Bytyqi nga Prishtina, e ka shpallur përgjegjës sepse: si Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë për vitin 2011 pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë i njoftuar se është i përfshirë në Listën e Zyrtarëve të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë nga pozita që e mban, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 par. 1 e sanksionuar sipas neni 17 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publike, për çka është gjobitur me gjobë në shumë prej 2300 (Dymijë e treqind) Euro. Me të njëjtën aktvendim i pandehur është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Izedin Bytyqi, ka paraqitur ankesë për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me arsyetim se nuk ka qenë i njoftuar nga zyrtari përkatës në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal se është i obliguar ta bëjë deklarimin e pasurisë konform ligjit përkatës. Gjykata është dashtë ta ketë parasysh faktin se obligimi i zyrtarëve për buxhet dhe financa që punojnë në ministri që ta deklarojnë pasurinë në Agjenci Kundër Korrupsionit është një obligim i ri dhe këtë ka hyrë në fuqi me ndryshimin e ligjit për deklarimin e pasurisë. Pra është viti i parë që obligohen për ta deklaruar pasurinë. Gjykata duke mos marrë parasysh faktet se unë jam i pafajshëm më ka shqiptuar gjobën më të lartë të mundshme që parashihet me ligj në vlerë prej 2300 Euro. Se gjykata me këtë rast nuk i ka marr për bazë provat dhe dëshmitë e ofruara siç janë të ardhurat mesatare të cilat unë i marr nga institucioni dhe gjendjen ekonomike në familje, duke mos marr për bazë asnjë rrethanë lehtësuese. I propozon Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, që ankesa të aprovohet dhe të pezullohet procedura kundërvajtëse.

2.

Kolegji i kësaj gjykate duke e vlerësuar ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur është pjesërisht e bazuar.

Kolegji pas shqyrtimit të thënieve në ankesë, aktvendimin e goditur, deklarin e dhënë të pandehurit Izedin Bytyqi, në seancën e shqyrtimit kryesor pranë Gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt. 21.05.2012, i cili në mbrojtjen e vet përveç tjerash deklaroj se nuk e kam bërë deklarin e pasurisë në Agjenci nga se nuk e kam ditur se duhet ta bëjë një gjë të tillë, duke shtuar se e kam pranuar një email nga Nazmije Krasniqi e cila më informon se jam i obliguar që ta bëjë deklarin e pasurisë; dëshmisë së dëshmitarit Enis Sadiku, përfaqësues i Agjencisë, në procesverbal të dt. 12.06.2012, i cili e vërteton se i pandehuri ka qenë i njoftuar për obligimin për deklarin e pasurisë dhe lidhur me këtë në shkresat e lëndës e ka deponuar si provë emailin e drejtuar zyrtarëve të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë, në mesin e tyre edhe i pandehuri Izedin Bytyqi, të dt. 02.03.2012, si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj pa dyshim se Gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer veprë kundërvajtëse, për të cilën mban përgjegjësi kundërvajtëse, nga se nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit edhe pse ka qenë i njoftuar dhe i obliguar ta bëjë një gjë të tillë, konform të nenit 17 par. 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Megjithatë Kolegji konstatoj se gjykata e shkallës së parë aktvendimin e atakuar e ka bazuar vetëm në rrethanat rënduese, gjersa, nuk janë përfshirë rrethanat lehtësuese të cilat sipas N. 7 të LK ka qenë e obliguar ti merr parasysht me rastin e përcaktimit të lartësisë se gjobës se shqiptuar, të cilat në bazë të provave të bashkangjitura kërkesës, të nxjerra dhe të administruara gjatë procedurës, padyshim se ekzistojnë, andaj në një masë e zvogëlojnë përgjegjësinë kundërvajtëse të pandehurit për veprën e kryer.

Andaj Kolegji vendosi që ta ndryshoj aktvendimin e goditur sa i përket gjobës së shqiptuar, duke marr parasysht rrethanat rënduese të cekura nga gjykata e shkallës së parë si dhe rrethanat lehtësuese sipas nenit 7 të LK-së, gjegjësisht faktin se është hera e parë që i pandehuri ka ra ndesh me ligjin, se nuk është i njohur si kryes i veprave kundërvajtëse të njëjta apo të ngjashme, se është hera e parë që është obliguar që ta deklaroj pasurinë pranë Agjencisë, se sipas aktit të emërimit të bashkangjitur shkresave të lëndës të ardhurat personale bruto i ka rreth 450 Euro, duke qenë të bindur se i pandehuri më nuk do ta përsërisë veprën e kryer.


Andaj Kolegji e ndryshoj aktvendimin e goditur vetëm sa i përket lartësisë së gjobës së shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë, në shumë prej 2300 ( Dymijë e treqind) Euro, ashtu që të pandehurit ia shqiptoj gjobën në shumë prej 1500 (Njëmijë e pesëqind) Euro, duke pasur për bazë të gjitha faktet dhe rrethanat në vështrim të nenit 7 të Ligjit për kundërvajtje duke llogaritur se edhe me këtë gjobë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit ashtu që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse të tilla apo të ngjashme. Më sa u tha më lartë konform të nenit 221 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk ka vend ankese.

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.**

**GJ.L. nr. 1309/2012 të dt. 20.11.2012.**

**SEK. JURIDIKE**  
Nexhmije Abazhik



**KRYETARJA E KOLEGJIT**

Mejreme Zekaj

